



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 1220  
Datë 28.09.2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 18.9.2020, mori:

**VENDIM**

Refuzohet kërkesa e ass. Besmir Sejdiu, asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, për lejimin e pushimit me pagesë për studime të doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoni, për periudhën 02.11.2020-01.11.2021.

**Arsyetim**

Ass. Besmir Sejdiu, asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka bërë kërkesë në Këshillin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike për lejimin e pushimit me pagesë për një vit, përkatësisht për periudhën prej 02.11.2020-01.11.2021, me qëllim të përfundimit të studimeve të doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoni. Kërkesën e tij, i përmenduri e bazon në nenin 148 të Statutit të Universitetit. Këshilli i Fakultetit ka dhënë rekomandim pozitiv (Konkluzion nr. prot. 1141, dt. 17.09.2020).

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e ass. Besmir Sejdiu, asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, dhe rekomandimin e Këshillit të Fakultetit konstatoi se kërkesa është e paarsyeshme, pasi neni 148 i Statutit të UMIB-it i referohet stafit akademik me thirrje akademik profesor, si dhe pushimi i lejuar sabbatikal ka të bëjë me kërkime të fokusuara shkencore dhe në këto raste kërkesës duhet t'i bashkëngjiten edhe dëshmitë që kërkohen me pikën 2 të nenit 148 të Statutit.

Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Dekanit të FIMK-ut.
3. Shërbimit financiar të UMIB-it,
4. Zyrës së personelit,
5. Zyrës për çështje akademike
6. Të përmendurit.

Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues

